

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm
ADRESA	https://lapsi.al/andi-bushati-gysi-bela-lali-klodi-si-mask-a-te-nje-njeriu-te-vetem-i1094438
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 09:18:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 09:12:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0c8e7b207722511b02866ff49bc61fd337ea79380c0b2cc17f4e5b16289b5d3a
TEKSTI	d888eac901f8e32def5b06cd1cd0df3dd21b4638a5b3e7b55635eb157589f5c5
PAMJA	d128f7a1821f21cfa956375188314e1337e3167f721da6f6681da593f4205154

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	64307cea186595d1cd720f9e8ddaa322371fbd1f149bbbbd268b13231c5fc0fd
E MËPARSHMJA	cdf65b65f5085e517dde2182afd02cc2be2199b409f342b675141fa612bb78d9
RRËNJA MERKLE	5232afb02d0ef3cfba4c89fffc05e27ccc8e2122c3335e6361f8bbb2dc579865
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/64307cea186595d1cd720f9e8ddaa322371fbd1f149bbbbd268b13231c5fc0fd

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm

Një shpjegim për habinë se si ka mundësi që kryespiunja dhe kryepolicja e vendit i bindeshin verbërisht një zhigolje anonim



ANDI BUSHATI • 25 SEPTEMBER 2026

Sikur nga trekëndëshi Agasi, Vlora, Proda të prodhohej një skenar filmi, pjesa më e madhe e spektatorëve do të dilnin buzërrudhur nga salla, pasi intriga do tu dukej shumë e stisur për të qenë e vërtetë. Por, në historinë mes Koordinatorit të krimit, Shefes së SHISH dhe Drejtorit të Përgjigjthëm të Policisë realiteti e tejkalon fantazinë. Me fuqinë që kishte marrë, Ergys Aagasi mund të dyfishonte me një fjalë goje buxhetin për një tender, ai mund të përfitonte mbi 40 milionë euro në vit përmes një firme fantazëm dhe pa punonjës, ai mund të krijonte apo zhbënte tituj pronësie, por mbi të gjitha duke pasur nën zgjedhë shefin e policisë dhe kryespiunin, mund të jepte urdhëra për rëmbim personash dhe pasi ti kryente me sukses të gjitha këto, të hapte nga një Romane Conti në zyrën me flutura, për të marrë nëpër gojë drejtuesit e institucioneve që kishte filmuar gjatë ditës.

Lexo më tej



23 SHTATOR, 14:39

Përgjimet ekskluzive/ "O shpirt", "o zemër". Vlora, një spiune që pasioni e çoi drejt krimit

Ndonëse kjo fabul mund të ngjajë në kufijtë e të paimagjinushmes, në mënyra të përafërta ajo është përsëritur edhe në raste të tjera.

Ata që kanë pasur rastin të lexojnë të plotë, bisedat e Belinda Ballukut me Vis Berberin gjejnë aty histori të frikshme. Mes mënyrës se si vendoste për dhënien e tenderave dhe trajtimit të historive rozë me bashkëpunëtorët, ajo demonstronte një pushtet të pakufishëm që buronte nga trajtimi i milionave si qindarka. Duke firmuar me një të rënë të lapsit 50 milionë euro te tuneli i Llogarasë, duke përfshirë një kompani britanike nga gara në Aeroportin e Vlorës e pastaj duke nxjerrë nga loja ata që ua kishte dhuruar në dëm të të parëve, ajo shpërfaq sjelljen e dikujt që si trembet asnjë llogaridhëniene. Vetëm kështu mund të shpjegohen ndarja e tenderave të unazës, nxjerrja e kompanive nga garat dhe porositë për çunat që duhet të blenin mediat me para.

Lexo më tej



11 SHTATOR, 16:13

EKSKLUZIVE/ Vilat në Dhërmi dhe Palasë, gati kërkesa e dytë e SPAK për arrestimin e Belinda Ballukut

I njëjtë është edhe modeli i Erion Veliajt, qoftë me kompanitë që kolliteshin tek shoqatat artistike e Ajolës, qoftë me drejtorët e SD, që kaluan direkt në firmat e tyre private mbi 22 milionë euro të buxhetit të stërmadh të bashkisë, për të ngritur me to hotele investitorësht strategjikë, ku punonjësit besonin se aksioner qe dhe vetë Lali.

Po të shkosh më tej, te inceneratorët inekzistentë që kanë përllarë gati gjysëm miliardi euro, do të kuptosh që një pjesë e parave të djegësve që nuk përfunduan kurrë shkonin ose për të blerë media, ose për fushatën e PS-së, ose në llogari jashtë që nuk kishin pikë lidhje me qëllimin për të cilin fondet kishin dalë nga buxheti. Kjo histori, e cila do të

ide



Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm

Andi Bushati



Rënia e Vlorës në shtratin e krimit

Armand Shkullaku

MOTITIRANA

18°C

KËMBIMIEURO

91.50

aktuale

08:49

Rama në OKB, në fokus Bordi i Paqes dhe çështja e ish-krerëve të UÇK-së

07:52



Rama sot në OKB, pritjet fjalimi në Asamblenë e Përgjithshme



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



shndërrohet vërtet në një produksion tronditës ndërkombëtar dëshmon për atë që, ndonëse nuk kishin në dorë faktet, e dinin të gjithë: Pra se për çfarë shërbenin paratë e zhdukura.

Lexo më tej



23 SHTATOR, 12:24

Bomba tjetër për qeverinë Rama/ Prova e fakte se ku shkojnë paratë e zhvatura nga korrupsioni

Në këtë kuptim, sado të ndryshëm të jenë në mes tyre, qoftë Gysi apo Bela, qoftë Lali apo njëri nga Klodët e inceneratorëve, trajektoret e tyre konvergojnë në një pikë. Pavarësisht nga mënyrat që përdorin, apo metodat që zgjedhin, ata kanë të njëjtin qëllim. Nuk ka rëndësi nëse janë rivalë apo armiq, nëse e shajnë apo luftojnë njëri-tjetrin, ata i bashkon synimi për të zhvatur dhe plaçkitur çdo qindarkë të shqiptarëve.

Si të tillë, ndonëse mund të kenë profile jo të ngjashme me njëri tjetrin, ata duhen parë si pjesë e të tërës. Ata nuk janë veçse maska me ngjyra të ndryshme të një njeriu të vetëm. Të atij që ka konceptuar, pranuar dhe dhënë lejen për planin masiv të grabitjes.

Prandaj, sa herë që na vetëtim në një mendje pyetje naive se si u bë e mundur që kryepolici dhe kryespiunja e vendit ti bindeshin si zara të rëndomtë një zhigoloje anonim, pa asnjë funksion apo pushtet faktik, ne nuk duhet të ndalemi vetëm tek trekëndëshi protagonist i këtij skenari të pabesueshëm. Ai nuk mund të shpjegohet nëse nuk ndërgjegjësohemi për planin e madh, nëse atë nuk e shohim thjeshtë si pjesë të një projekti të vendosur përtej dhe sipër tij. Vetëm kështu enigma bëhet e thjeshtë, atëhere kur atë e kuadron përkrah historive të Saimir Tahirit, Ilir Beqajt, Lefter Kokës, Erion Veliajt dhe Belinda Ballukut. Vetëm në këtë rast ajo nuk bëhet më një fabul në të cilën fantazia vret të vërtetën, por thjeshtë realiteti i një bande grabitësishe vulgarë, që prej trembëdhjetë vjetësh kanë pasur projektin e vjedhjes së këtij vendi.

LAPSI.al

Të këshilluara



Rënia e Vlorës në shtratin e krimit

Vlora nuk është as dardhë e as pjeshkë që dikush e ha pas shpinës së kryeministrit. Ajo është ilustrimi më eklatant se si vetë Edi Rama i ka vënë institucionet e vendit në shërbim të pushtetit të tij, që në thelb është pushteti i krimit



Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes man-izmi

Nga drama e 16 shtatorit, që po rekemi ta konsumojmë si popujt primitivë me lotë, mallkime, ofshama dhe qurravitje duhet të dimë të nxjerrim një mësim: Këtë e tutje askush nuk do të na rrespektojë, po nuk ditëm të respektojmë vetveten. Sepse verdikti i asaj gjykate të instrumentalizuar erdhi si pasojë e servilizmit tonë të verbër ndaj perëndimit



Takime me agjentë serbë?/ Gazetarja Klodiana Lala flet për deklaratën e Vlora Hysenit



Vlora Hyseni shantazhon publikisht gazetaren Klodiana Lala



Vlora Hyseni i jepte garanci Ergys Agasit: Krejt radarët e shtetit i fik për ty



Kush ia dërgoi Agasit aktin e ekspertimit të kriminalistikës për gjurmë gishti, fije floku dhe...



Gënjeshtra e rezortëve elitare



Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?

Deri më tani për ta nxjerë Lalin nga burgu u përdor alibia e mos dëmtimit të interesit të qytetarëve dhe punëve të Tiranës. Këtëj e tutje, pasi mirë apo keq, Gjykata e Lartë vendosi të lërë edhe për një kohë relativisht të gjatë të izoluar, duhet të jesh i pafytyrë që të mbrosh idenë se ai mund të mbetet kryebashkiak edhe në dëm të këtij interesi



Ortaku besprerë i Ron Yeffetit

Fabula e përdorimit të sipërmarrës Arieta Puca, që u promovua nga Rama, për ti hapur rrugën hyrjes në skenë të mikut të tij hebre, përbën realizimin më gjenial të të njëjtit skenar të rilindjes: "Sa më e madhe ëndrra që hidhet në treg, aq më e rëndë është goditja financiare që po përgatitet"



Insistimi tek krimi, arësyeja përse kryeministri Rama duhet të dorëhiqet

Insistimi i Ramës se projekti në Zvërnec do zhvillohet edhe pse ai është tashmë simbol i një krimi të trefishtë (ambiental, ekonomik dhe politik) të qeverisjes aktuale tregon se ai ose nuk mundet ose nuk do të degjoje thirrjen e protestes



Fabula e re e Edi Ramës: Shqiptarëve pasqyrën, për vete milionat



Blendi Kajsio: Skandali i vërtetë në rastin Veliaj

Që në momentin e marrjes si i pandehur një standarti politik minimal diktonte dorëheqjen e tij nga detyra në funksion të interesit të Tiranës dhe qytetarëve të saj



Po sikur Lali të dalë nga burgu?


Një pakt është përvijuar mes kryeministrit dhe kryebashkiakut të burgosur për të kthyer këtë të fundit në zyrë. Po cila do të qe konsequenca për një reformë në drejtësi, që pushtetarët e lartë ia shkëllyen dyert e qelive?



Një moment vendimtar për Shqipërinë

Është hera e parë që shqiptarët ndihen se mund ta formësojnë debatin kombëtar pa pritur që partitë politike të marrin drejtimin. Përvoja na mëson se demokracia varet jo vetëm nga zgjedhjet, por edhe nga qytetaria aktive mes tyre.

Me sytë katër



23:13

PAMJET/ Protestuesit kapin Bledi Çuçin në kafe, bashkëshortja e tij Delina Fico humb durimin

Deputeti i Partisë Socialiste Bledi Çuçi ka qenë "viktima" e radhës e protestuesve në Tiranë, të cilët i kanë...



VIDEO/ Muriqi feston me bluzën e UÇK-së golin ndaj Irlandës

22:44



Kryemadhi: Si nuk i fiku njeri radarët për ne! Meta vetëm i ndizte

28:36



PAMJET VIRALE/ Presidenti i Haitit pi ujë me kanë në mes të OKB-së

22:43



PAMJET/ Rrëzohet gjatë stërvitjes në Uells avioni ushtarak britanik

21:28

SPORT

→ Të tjerë artikuj



Inter, shifra rekord: 518 milionë euro të ardhura, rezultati i dytë më i mirë në histori, e 22,7 milionë fitim



Stekë bilardo apo pushkë? Lojtari i Izraelit Abu Farchi përjashtohet e pas polemikave sqaron festimin e tij



Klopp 'tradhtohet' nga Gakpo, Holanda eviton rënien me Gjermaninë: Haaland udhëheq Norvegjinë, Felix Portugalinë



Muriqi shemb Irlandën e tregon fanellën e UÇK-së: në "Fadil Vokrri" Kosova dominon totalisht Irlandën



Cristiano Ronaldo refuzoi pagën e parë në Arabi që të paguheshin shokët e skuadrës: kishin 6 muaj pa marrë rrogë



Rrëfimi tronditës i Andy Carroll: "Pësova dhunë sek*uale nga një mik i famshëm. E gjeta në shtratin tim"



Matthaus dhe e dashura 27-vjeçare pas pesë martesash e pesë divorcesh: "E sigurtë, nuk do të martohem më"



28:39



Një dekadë pas martesës, zbulohet ndryshimi i papritur që bëri Margot Robbie

28:32



Selena Gomez dhe Benny Blanco drejt zgjerimit të familjes? Këngëtarja zbulon planet për të ardhmen

28:26



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.